




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 01/005/12

Datë: 04.05.2012

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 1, 2, 3 dhe nenit 49, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.3 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. **Urdhërohet** Banka TEB Sh. A. që të ndalojë praktikën e përpunimit të të dhënave personale me qëllim të ofrimit të kredit kartelës pa pëlqimin paraprak të klientit.
2. **Urdhërohet** Banka TEB Sh. A. që të asgjësojë dosjen e krijuar për krijimin kredit kartelës së e klientit K. R.
3. Vendimi të realizohet në afat prej 8 ditësh.
4. Në afat prej 15 ditëve të njoftohet Agjencia për zbatimin e vendimit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të vendimit.

Arsyetim

Agjencia, më datën 27.04.2012, përmes postës elektronike ka pranuar një ankesë nga ankuesi K. H. i cili ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me një njoftim përmes SMS-së nga ana e Bankës TEB Sh. A. përmes së cilit është njoftuar se ka të gatshme kredit kartelën. Në SMS shkruan " I/E nderuar K.H. TEB Banka ju njofton se kredit kartela juaj është gati dhe mund ta merrni në degën në Prishtinë, Rr. A. Ramadani 15, Faleminderit". Pas këtij njoftimi përmes SMS-së, TEB Sh. A. ka telefonuar dy herë radhazi ankuesin për të marrë kartelën, por që i lartcekuri ka refuzuar këtë ofertë. Pas një kohe është dërguar edhe një njoftim përmes SMS-së, në të cilën shkruan "I/E nderuar K.H. , TEB Banka përsëri ju njofton se kredit kartela juaj është gati dhe mund ta merrni deri më datën 26/04/2012". Ankuesi K. H. në ankesën e tij shprehë shqetësimin se si ka mundësi që ti bëhet gati kredit kartela e tij pa kërkesën dhe pëlqimin e tij.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia, në mbledhjen e Këshillit të datës 26.04.2012 ka caktuar mbikëqyrësit Bekim Demiri dhe Aleksandar Spasić që ta shqyrtojmë këtë ankesë. Të njëjtën ditë është njoftuar kontrollori TEB Sh. A. dhe është caktuar data e inspektimit lidhur me këtë ankesë.



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Më datën 02.05.2012 është realizuar inspektimi në lokalet e Bankës TEB Sh. A. Pjesëmarrës nga ana e Bankës TEB Sh. A. ishin D. S., B. Z. dhe D. Sh. si dhe nga ana e Agjencisë, mbikëqyrësit e Bekim Demiri dhe Aleksandar Spasić. Nga biseda që patëm me zyrtarët e Bankës TEB Sh. A. dhe dëshmime të SMS-ve, u konstatua që nuk ka qenë hapje e llogarisë bankare, por është bërë një ofertë nga ana e tyre për kredit kartelë dhe vetëm pasi të pranohej oferta nga ana e klientit atëherë ai do të ftohej në bankë në mënyrë që të nënshkruajë kontratë për këtë shërbim.

Kjo praktikë e këtyre ofertave u pranua se realizohet nga ana e bankës dhe se të dhënat grumbullohen në forma të ndryshme që nga aplikimi për punësim, pagesat e ndryshme, deponime të ndryshme, etj.

Në lidhje me rastin në fjalë, banka na ofroi dëshmi që Z. K. H. ka kryer një transaksion bankar më 01/06/2009, në të cilën rast i është marrë edhe kopja e letërnjoftimit me qëllim të identifikimit. Si rrjedhojë, Banka TEB Sh. A. ka poseduar të dhëna të mjaftueshme për ti ofruar një kredit kartelë Z. K. H. Nga dëshmitë e ofruara nga ana e Bankës TEB Sh. A. konstatohet se Z. K. H. nuk ka aplikuar për kredit kartelë nga ana e bankës.

Nga sa u tha më lart, konstatohet që Banka TEB Sh. A. ka bërë shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përkatësisht nenin 3, paragrafi 1, 2, 3, në të cilat thuhet se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave, të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe ose përpunuar më tutje, të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime.

Në bazë të nenit 49, paragrafi 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësit shtetërorë kanë marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Bankës TEB Sh. A.
- Arkivit të Agjencisë



Mbikëqyrës Shtetërorë

Bekim Demiri

Aleksandar Spasić